

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **70433736-25-5092-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi me kemikate per trajtimin e ujit**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>SAMET MESTANI B.I.</b>
NUI	<b>810589674</b>
Adresa	<b>Prizren, Nr.37, Pejës</b>
Vendi	<b>Prizren</b>
Kodi postar	<b>20000</b>
Numri Telefonit	<b>+49 1792379473</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Samet Mestani</b>
Adresa elektronike	<b>samet.mestani@hotmail.de</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>27.08.2025</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

#### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Sulfat Alumini[]Klor gaztë dhe atestim I kontiniereve 1000kg dhe bombolave 150 kg dhe hipoklorur natriumi[]Algacid[]Dioksid klori[]Polielektrolit anjonik**

**Emërtimi: Furnizimi me kemikate per trajtimin e ujit**

**Kodi/Numri: 70433736-25-5092-1-1-1**

**Njoftimi për kontratë: 06.06.2025**

**Hapja e ofertave: 16.07.2025**

**Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 08.08.2025**

#### **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

Jo

#### **5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

#### **6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

Jo

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**Kërkesë për rishqyrtim të vendimit: 13.08.2025 14:43**

**Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim: 21.08.2025 10:29**

#### **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit,*

*dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L092 (Versioni i Konsoliduar), Nenet si në vijim:

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Me date 16.07.2025 kemi dorëzuar ofertën për këtë aktivitet të prokurimit, konform të gjitha kushteve dhe kriterëve të dosjes së tenderit.

Me 08.08.2025 kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesit e eliminuar dhe Njoftim mbi Vendimin e AK për rekomandim me kontratë Operatorëve Ekonomik Seykos SH.P.K..

Në bazë të dokumentacionit duke krahasuar me kërkesat si në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë kemi konstatuar se Komisioni Vlerësues kundërligjshëm ka rekomanduar për fitues një OE të papërgjegjshëm me këto shkelje:

Ne tenderin e juaj me Numer të Prokurimit 70433736-25-5092-1-1-1 në NPT Mayer & Mestani Chemie nga Prizren si ofertues edhe pse kemi qenë me çmim për 28.800 Euro më të lirë se sa oferta OE SEYKOS sh.p.k. Ju e kemi shpërblyer ndermarrjen e lartëpërmendur me arsyetimin se ne në ofertën tonë e kemi dhënë Çmimin me tri decimale pas presjes dhjetore e Jo me dy siç e parasheh LPP.

Por çmimi perfundimtar i ynë për 900 Tona ka qenë 295.200,00 Euro, pra me dy decimale pas presjes dhjetore.

LPP nuk e ka përcaktuar njësinë se a duhet të jetë në gram (g), kilogram (kg) apo Tonelat, dhe ne si OE kur i kërkojmë ofertat e sasive të mëdha nga prodhuesit i marrim për tonelate e jo për kg.

Pastaj edhe ne i llogarisim çmimet për tonelat dhe në këtë rast çmimi ynë ka qenë 328 Eur/T kurse ju e kemi kërkuar si njësi kg. Në çmimin për tonelat e kemi pjestuar për 1000 kg dhe kemi marrë çmimin 0,328 EUR/kg. Ne si kompani nuk e shohim të arsyshme që ne

mos të shperblehemi me Lotin nr. 1 për Sulfatin e Aluminit 17/18% dhe të shperblehet OE Seykos sh.p.k. edhe pse per 28.800 Euro është më shtrejtë se oferta jonë dhe të keqperdoret para ja publike.

Sipas RRPP, pikës 17.11 Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmimin për njësi me TVSH me më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tillë do të konsiderohet e papërgjegjshme. Në rast se Autoriteti Kontraktues lejon çmime me më shumë se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK një informatë të tillë duhet t'a përcaktojë në dosjen e tenderit dhe duhet të përdorë Listën e çmimeve jo-standarde.

Në lidhje me këtë ju sqaroj se:

**Ju si AK nuk e keni përdorur Listën e çmimeve Standarde, andaj sipas RRPP pika: 17.8 Për të gjitha procedurat e përgatitura përmes platformës elektronike, AK duhet të përdorin vetëm Listën e çmimeve standarde e cila krijohet nga sistemi ose jo-standarde në formatin excel e cila krijohet nga vetë përdoruesi. Në sistem të prokurimit elektronik dosja e tenderit dhe lista e çmimeve publikohen si dokumente të ndara.**

**Gjithashtu: çmimin për njësi me TVSH me më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore NUK mund të përdoret në tenderët që nuk është e saktësuar (caktuar) sasia e furnizimit por është për njësi 1 copë, ndërsa në këtë tender sasia është mjaft mirë e përcaktuar.**

Në të njëjtin Tender me numer prokurimi 70433736-25-5092-1-1-1 per lotin nr.4 Dioxid klori 0,3% na keni shperblyer kunder rregullave te LPP. Pse na keni shperblye kunder rregullave te LPP ?

Sepse kemi qenë të vetmit ofertues dhe i keni mbyllë syte dhe e keni shkel LPP?

Specifikacioni jonë i tretsires së dioksidit të klorit 0,3% nuk perputhet ne asnje pikë me specifikacionin e Juaj si AK. Kontrolloni mire dhe krahasoni.

Sa i perket LPP qe Ju si AK po e rrespektoni në përpikmëri, pse vitin e kaluar e shperblyet OE Seykos sh.p.k. kur e keni ditur se të gjithë dokumentacionin e ka pasur të manipuluar nga një ndermarrje nga Bullgaria me çertifikate jo valide të një Laboratori nga Shkupi dhe në funde Ju ka furnizuar me Sulfatin e Aluminit 17/18% nga Serbia nga ndermarrja Impuls Hemija dhe ju këtë e keni pranuar në heshtje.

A nuk është ky mashtrim nga OE Seykos dhe nga Ju si AK. Te dy palet keni qenë pjesmarres në mashtrim dhe keni kosumuar veper penale.

Vitin e kaluar nuk e kam dërguar në OSHP sepse kam menduar mos ta vonoj procesin e furnizimit dhe mos të keni pengesa në përgaditjen e ujit për qytetaret e Prishtines me rrethinë.

Pretendimi ynë është i bazuar në dëshmi dhe fakte të cilat lehtësisht mund të verifikohen, dëshmi të cilat i potencuam edhe më lartë, prandaj kërkojmë që NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES –B 58 i këtij tenderi të anulohet dhe të aprovohet kërkesa jonë për rivlerësim të tenderit, dhe pas një vlerësimi korrekt të shpallemi NE si fitues i tenderit në fjalë.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Konsiderojme që kemi bërë shpenzime materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, për përgaditjen e ankesës si dhe dëmtime tjera në fitimin e pritur, vlerë të referencave, imazh dhe dëmtime tjera që mund të ndodhin**

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*